



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/2023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 18.07.2025, nxjerrë këtë

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me numër të protokollit:DPKI-854/25,për zyrtarin e lartë Visar Haxhibeqiri, Drejtor i Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Gjakovë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, pasi që është shmangur e gjendja e papajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik, për shkak të ndryshimeve të bëra nga zyrtari i lartë për sa i përket funksionit menaxhues në biznesin privat konform nenin 13, paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe e njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë Visar Haxhibeqiri, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: LPKI).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) ka fillua trajtimin e këtij rasti sipas detyrës zyrtare, pasi që zyrtari i lartë Visar Haxhibeqiri, krahas ushtrimit të funksionit publik si zyrtar publik respektivisht Drejtor i Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Gjakovë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ishte përfaqësues i autorizuar dhe Drejtor në biznesin "CO-DESIGN" SH.P.K. Gjakovë.

Sipas procedurës, në pajtim me nenin 22, paragrafi 3 dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, ka dërguar shkresën zyrtare APK-DPKI-06-945/25, duke e njoftuar zyrtarin e lartë për fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik. Më pas zyrtari i lartë Visar Haxhibeqiri është kontaktuar, si dhe i është sqaruar fakti se gjatë ushtrimit të funksionit publik, ai nuk mund që njëkohësisht të mbajë funksion drejtues e as të jetë drejtor menaxhues në një biznes private, sepse kjo situatë paraqet gjendje të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, siç përcaktohet me nenin 13, paragrafi 1, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku thuhet se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”.

Zyrtari i lartë Visar Haxhibeqiri, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë dhe ka deklaruar se do të ndërmarrë veprime të menjëhershme në mënyrë që të shmang gjendjen e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik.


Ndërkohë, zyrtari i lartë Visar Haxhibeqiri ka dërguar në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Certifikatën e Regjistrimit bashkangjitur me *Informatën mbi biznesin*, ku rezulton se i njëjti ka bërë ndryshimet e nevojshme, duke u tërhequr nga pozita e përfaqësuesit të autorizuar dhe funksioni drejtues në biznesin “CO-DESIGN” SH.P.K. Gjakovë, përkatësisht ka bartur të drejtat e drejtimit të ndërmarrjes (biznesit) të sipërpërmendur tek një person tjetër (personi i besuar).

Nga veprimet e ndërmarra nga zyrtari Visar Haxhibeqiri, i cili duke hequr dorë nga ushtrimi i funksionit të personit të Autorizuar- Drejtorit Menaxhues në kompaninë “CO-DESIGN” SH.P.K. Gjakovë, është vërtetuar se janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur papajtueshmëria në ushtrim të funksionit publik, duke konstatuar se është bërë transferimi i të drejtave në udhëheqjen dhe menaxhimin e ndërmarrjes duke u shmangur gjendja e papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik për sa i përket funksioneve në bizneset e sipërpërmendura.

II. Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: *“Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.”*, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: *“Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”*

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:


Ylli Buleshkaj
Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)